



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:200142

Datë: 27.03.2025

Numri i dokumentit: 07058268

P.nr.669/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerinda Laiq, në çështjen penale kundër të pandehurit Cenë Vukeli, nga P., për shkak të veprës penale “Ndërtim pa leje” nga neni 359 par.4 e lidhur me par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 04/L-082 (KPRK), duke vepruar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjë PP/II.nr.2352/2023, të datës 01.08.2024, pas shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e shtetit Lumturije Hoxha, i pandehuri Cenë Vukeli, mbrojtësi i tij av. Egzon Berljajolli, nga P., i caktuar sipas detyrës, me datë 20.03.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 27.03.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

CENË VUKELI, nga babai I.dhe i nënës Z., e vajzërisë L., i lindur me në fsh. N., Komuna e Pejës, ku edhe tani banon, rr. “A. D.” nr. 59, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, posedon nr. telefonit, i identifikuar me letërnjoftim sipas nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Prej datës së pavërtetuar, e në vazhdimësi deri më datë, rreth orës 12:00, në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” në vendin e quajtur Rajoni i Sh., i pandehuri si pronar dhe investues duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit për ndërtim nr. 04/L-110 kryen punë ndërtimore pa leje paraprake të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor të Komunës së Pejës, në atë mënyrë që gjatë kontrollës së terrenit nga zyrtarët policor dhe zyrtarët nga Drejtoria e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” është vërejtur se i pandehuri në pronën publike kishte filluar ndërtimin e një stan – deban me material të fortë blloka me bazament prej betonit, edhe pse i vetëdijshëm, se ndërtimi po kryhej në pronë me destinim të veçantë dhe pa leje valide nga organet kompetente,

- Me çka ka kryer veprën penale **“Ndërtim pa leje”** nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së,

Andaj, gjykata, në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69 dhe 359 par.4 e lidhur me par.2 të KPRK-së, dhe neneve 364, 449 dhe 462 të KPPK-së, të pandehurin:

E G J Y K O N

- I.** Me **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën verifikuese prej dy (2) vitesh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi i pandehuri nuk kryen veprën tjetër penale.
- II.** Nëse i pandehuri, brenda periudhës së verifikimit të cekur si më lartë, kryen veprën tjetër penale, dënimi i kushtëzuar si në pikën I të këtij dispozitivi do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- III.** Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në formën e paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe shumën prej njëzetë (20) euro, në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.
- IV.** Konform nenit 359 par. 5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074, URDHËROHET RRËNIMI i objektit të ndërtuar pa leje në zonën e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi dhe shpenzimet e rrënimin bien në barrë të të pandehurit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën nën shenjë PP/II.nr. 2352/2023, të datës 01.08.2024, kundër të pandehurit Cenë Vukeli, për shkak të veprës penale **“Ndërtim pa leje”** nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 04/L-082 (KPRK).

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datën 18.03.2025, ku në seancë kanë qenë të pranishëm Prokurorja e shtetit Lumturije Hoxha, i pandehuri Cenë Vukeli, mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av. Egzon Berlajolli, nga P..

Në seancën e shqyrtimit fillestar, pasi që të pandehurit nga ana e gjykatës i janë komunikuar të drejtat dhe detyrimet e tij ligjore, si dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i akuzuari ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale, të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarohet mbi fajësinë, por paraprakisht i janë shpjeguar kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ashtu që i njëjti me vullnet të

plotë ka deklaruar së pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, respektivisht për veprën penale “Ndërtim pa leje” nga neni 359 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës, pa asnjë ndryshim.

Gjykata ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ashtu që prokurori i shtetit ka deklaruar së: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ky pranim i fajësisë i plotëson kushtet ligjore dhe ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, kërkoj nga gjykata që ky pranim fajësie të aprovohet dhe ky pranim të mirët si rrethanë posaçërisht lehtësuese, ngjashëm është deklaruar edhe mbrojtësi i të pandehurit av. Egzon Berlajolli, i cili ka deklaruar se: i njëjti pas konsultimit me mua si mbrojtës, i ka të qarta benefitet e pranimin të fajësisë dhe këtë e bënë në baza vullnetare dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtin ta aprovoj.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti së në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin së gjykata ka gjetur së i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, së një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, së pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti fillestar i incidentit me nr. 2023-DA-855, e dt. 07.06.2023 nga hetuesi K. Z., Raporti i policit K. Z. e dt. 07.06.2023, Raporti informues nga polici hetues S.A. e dt.07.06.2023, Akt përcjellës nga DAPK e dt. 06.10.2023, Procesverbal mbi kontrollin e kryer me nr. 001114 e dt. 06.10.2023, Deklarata e të pandehurit Cenë Vukeli e dhënë në Stacionin Policor në Pejë, me dt. 17.11.2023 dhe në Prokurori me dt. 26.07.2024, si dhe foto albumi nga vendi i ngjarjes. Po ashtu, gjykata ka gjetur së aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par. 6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.*

Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxha, sa i përket rrethanave lehtësuese dhe rënduese, ka deklaruar se: *sa i përket rrethanave lehtësuese i propozoj Gjykatës që të marrë parasysh pranimin e fajësisë siç e ceka më lartë ndërkaq si rrethana rënduese ia lë në vlerësim gjykatës.*

Mbrojtësi i të pandehurit Cenë Vukeli, av.Egzon Berlajolli, ka deklaruar se: *i propozoj gjykatës që si rrethanë posaçërisht lehtësuese të marr pranimin e fajësisë, faktin që i njëjti asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin më parë, veprën penale e ka bërë nga padituria e tij për pajisje me leje ndërtimi, dhe të njëjtën e ka ndërtuar për shkak se prindi i tij tashmë i ndjerë ka vuajtur nga sëmundja e kancerit, dhe kërkoj që të gjitha këto të merren parasysh me rastin e shqiptimit të dënimit.*

I pandehuri Cenë Vukeli, ka deklaruar se: *jam penduar për veprën penale që kam kryer, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale të tilla, më vjen keq për atë që*

ka ndodhur, vepra penale është kryer pa ndonjë qëllim, veprën penale e kam kryer për shkak që prindi im ka qenë i sëmurë dhe për benefite shëndetësore e kam ndërtuar.

Prandaj, me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Ndërtimi pa leje” nga neni 359 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Nga faktet e vërtetuara nga shkresat e lëndës, nga deklaratimet e palëve në procedurë dhe nga vet pranimi i fajësisë nga e të pandehurit, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj gjykata edhe e shpalli fajtor të njëjtin pasi që më parë gjeti se penalisht është përgjegjës.

Me rastin e përcaktimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si në vijim: si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën ngarkohet, se i njëjti është i pa dënuar më parë dhe se kjo pra është hera e parë që bie ndesh me ligjin, pendimin e shprehur për kryerjen e veprës penale si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale, ndërsa rrethana rënduese në rastin konkret gjykata nuk gjeti, andaj duke u nisur nga të gjitha këto gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim me burgim të kushtëzuar si në pikën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 69 par. 3, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit me kusht u mor në përputhje me nenin 48 par.1 dhe 2, e lidhur me nenin 49 par.2, dhe par.4 të KPRK-së, ku në dispozitivin par.1 të nenit 49, që i referohet kushteve mbi shqiptimit e dënimit me kusht përcaktohet se: “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit”, ndërkaq në par.4 përcaktohet se: “Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale”.

Andaj, meqenëse për veprën penale “Ndërtim pa leje” nga neni 359 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së, parashihet dënimi maksimal deri në tetë (8) vjet dhe konform nenit 71 par. 1, nën par. 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK – së, duke pasur parasysh se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe pendimin e shprehur në gjykatë, i shqiptoj dënim me kusht me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit. Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej dy (2) vitesh do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do të ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitivin e këtij aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që i njëjti të parandalohet në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Në kuptim të nenit 50 të KPRK-së, gjykata do të revokojë dënimin e kushtëzuar nëse i pandehuri kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit.

Në nenin 359 par. 5 të KPRK – së, parashihet se: “Ndërtimi pa leje në këtë nen duhet të rrënohet dhe shpenzimet e rrënimit barten të kryesi”. Bazuar në nenin 359 par. 5 të KPRK – së, gjykata vjen në përfundim se, të vepra penale “Ndërtimi pa leje” nga neni 359 të KPRK – së, nuk është qëllimi i vetëm që i pandehuri të shpallet fajtor për veprën penale, mirëpo krahas dënimit, gjykata obligohet që të veproj konform paragrafit 5 të nenit 359 të KPRK– së, duke urdhëruar që ndërtimi i objektit pa leje të rrënohet dhe shpenzimet e rrënimit barten të kryesi. Pra, shqiptimi i dënimit të pandehurit dhe rrënimi i objektit pa leje, duhen të shqiptohen kumulativisht, andaj nga të cekurat më lartë, gjykata ka urdhëruar rrënimin e objektit të ndërtuar pa leje të precizuar si në dispozitiv të aktgjykimit duke u bazuar në nenin 359 par. 5 të KPRK – së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale në formë të paushallit gjyqësor, është marr në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për programin e kompensimit të viktimave, është marr konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.669/24, me datën 27.03.2025.

Zyrtarja ligjore

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Blerinda Laiq

Blerta KELMENDI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e pakënaqur brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa parashtrohet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.